

RAPORT

MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT

ADMINISTRATA QENDRORE
2025





RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT ADMINISTRATA QENDRORE - 2025

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,

Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771

Përmbajtja:

RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT ADMINISTRATA QENDRORE - 2025	2
1. HYRJE.....	5
1.1 Konteksti i monitorimit dhe raportimit mjedisor	5
1.2 Rëndësia e monitorimit mjedisor në procesin e vendimmarrjes	7
1.3 Monitorimi mjedisor në kuadër të politikave të Bashkimit Evropian	9
1.4 Sistemi institucional i monitorimit mjedisor në Republikën e Kosovës ...	11
1.5 Qëllimi i raportit.....	13
1.6 Objektivat e raportit	15
2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	17
2.1 Qasja metodologjike	17
2.2 Burimet e të dhënave	18
2.3 Instrumentet e mbledhjes së të dhënave	19
2.4 Institucionet e përfshira në hulumtim	21
2.5 Metoda e analizës	22
2.6 Kufizimet e hulumtimit	24
3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	25
3.1 Korniza ligjore për monitorimin dhe raportimin mjedisor	25
3.2 Organizimi institucional i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor	27
3.3 Raportimi mjedisor në Republikën e Kosovës.....	29
3.4 Harmonizimi me acquis të Bashkimit Evropian.....	31
4. ANALIZA E SISTEMIT TË MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT MJEDISOR NË ADMINISTRATËN QENDRORE.....	33
4.1 Skema institucionale dhe kapacitetet njerëzore.....	34
4.2 Korniza ligjore	38
4.3 Dokumentet e planifikimit, programet, projektet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit.....	41
4.4 Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor.....	43

4.5 Sistemet e monitorimit mjedisor	45
4.6 Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore	48
4.7 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike	51
4.8 Licencimi dhe lejet mjedisore	53
4.9 Gjetjet kryesore të analizës.....	56
5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	59
5.1 Përfundimet	59
5.2 Rekomandimet.....	61
6. REFERENCAT	64
Për EC:.....	65

1. HYRJE

1.1 Konteksti i monitorimit dhe raportimit mjedisor

Mbrojtja e mjedisit përbën një nga shtyllat themelore të zhvillimit të qëndrueshëm dhe lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien e qytetarëve, ruajtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin ekonomik afatgjatë. Përballë presioneve të vazhdueshme që burojnë nga urbanizimi, zhvillimi industrial, ndryshimet klimatike, shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore dhe rritja e ndotjes, monitorimi dhe raportimi mjedisor përbëjnë mekanizma themelorë për vlerësimin objektiv të gjendjes së mjedisit dhe mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë. Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, i publikuar në tetor 2025 thekson se gjendja aktuale e mjedisit në Republikën e Kosovës paraqet një sfidë të vazhdueshme për institucionet përgjegjëse, shoqërinë civile dhe qytetarët në përgjithësi. Ndikimi i aktiviteteve ekonomike, urbanizimi i shpejtë, mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të ndotura, si dhe përdorimi i paqëndrueshëm i resurseve natyrore, ka sjellë pasoja serioze në komponentët kryesorë të mjedisit. Ky raport i hartuar nga EC Ma Ndryshe ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve në sektorët kryesorë të mjedisit, duke analizuar trendet, sfidat dhe funksionimin institucional në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Monitorimi mjedisor nënkupton procesin sistematik të mbledhjes, analizimit, interpretimit dhe raportimit të të dhënave mbi komponentët kryesorë të mjedisit, përfshirë cilësinë e ajrit, ujërave dhe tokës, biodiversitetin, menaxhimin e mbeturinave dhe ndikimet në shëndetin e popullatës. Përveç evidentimit të gjendjes aktuale, monitorimi mundëson identifikimin e trendeve mjedisore, vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve njerëzore dhe matjen e efektivitetit të politikave dhe masave të ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit. Kjo

qasje pasqyrohet edhe në strukturën e Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit, i cili trajton në mënyrë të integruar komponentët kryesorë të mjedisit, ndikimet në shëndetin e njeriut, zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit, funksionimin institucional dhe financimin e sektorit mjedisor.

Në nivelin e Bashkimit Evropian, monitorimi dhe raportimi mjedisor zhvillohen në kuadër të një sistemi të integruar të informacionit mjedisor, i cili mbështetet në indikatorë të harmonizuar dhe në bashkëpunimin ndërmjet vendeve përmes Agjencisë Evropiane të Mjedisit (European Environment Agency – EEA) dhe Rrjetit Evropian për Informacion dhe Vëzhgim Mjedisor (European Environment Information and Observation Network – EIONET). Sipas raportit *Mjedisi i Evropës 2025 – Profili i Kosovës*, vlerësimi i progresit të Kosovës mbështetet në tregues të zhvilluar nga EEA dhe Eurostat, të cilët fokusohen në tri fusha kryesore: mjedisin dhe klimën, ndryshimet socio-ekonomike dhe transformimin e sistemeve të energjisë, transportit dhe ushqimit.

Raporti vlerëson se Republika e Kosovës ndodhet në një fazë të rëndësishme të tranzicionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithëse janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, ekonomisë qarkore dhe bujqësisë së qëndrueshme, vendi vazhdon të përballë me sfida të konsiderueshme, si varësia nga lëndët djegëse fosile, menaxhimi joefikas i mbeturinave, fragmentimi i tokës bujqësore dhe varfëria energjetike. Në këtë kontekst, zhvillimi i një sistemi funksional të monitorimit dhe raportimit mjedisor është thelbësor për sigurimin e të dhënave të besueshme që mbështesin planifikimin strategjik, hartimin e politikave publike dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra.

Për nevojat e hartimit të këtij raporti të monitorimit dhe raportimit mjedisor është zhvilluar Metodologjia për Monitorimin dhe Raportimin Mjedisor, e

hartuar nga organizata EC Ma Ndryshe. Metodologjia shërben si instrument për mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e informacionit mbi funksionimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës. Ajo përfshin pyetësorë të standardizuar dhe indikatorë për vlerësimin e organizimit institucional, kornizës ligjore, kapaciteteve njerëzore dhe teknike, sistemeve të monitorimit, menaxhimit të të dhënave mjedisore dhe proceseve të raportimit. Përmes kësaj qasjeje mundësohet një analizë e strukturuar dhe e krahasueshme e institucioneve përgjegjëse, duke krijuar bazën për identifikimin e sfidave, boshllëqeve dhe formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

1.2 Rëndësia e monitorimit mjedisor në procesin e vendimmarrjes

Vendimmarrja efektive në fushën e mjedisit mbështetet në informacion të besueshëm, të krahasueshëm dhe të përditësuar mbi gjendjen e komponentëve kryesorë të mjedisit. Në këtë kuadër, monitorimi mjedisor përbën mekanizmin bazë për mbledhjen, analizimin, interpretimin dhe raportimin sistematik të të dhënave që lidhen me cilësinë e ajrit, ujërave dhe tokës, biodiversitetin, menaxhimin e mbeturinave dhe faktorë të tjerë me ndikim në mjedis dhe në shëndetin e popullatës. Të dhënat e gjeneruara nga procesi i monitorimit krijojnë bazën për hartimin e politikave publike, përcaktimin e prioriteteve strategjike, planifikimin e investimeve dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit.

Monitorimi mjedisor nuk ka vetëm funksion përshkrues, por përbën një element thelbësor të ciklit të politikëbërjes. Informacioni i siguruar përmes monitorimit përdoret për identifikimin e problemeve mjedisore, analizimin e trendeve

afatgjata, vlerësimin e ndikimeve të aktiviteteve ekonomike dhe matjen e rezultateve të politikave publike. Në këtë mënyrë, monitorimi mbështet vendimmarrjen e bazuar në evidencë (*evidence-based policy making*), duke siguruar që vendimet strategjike të bazohen në të dhëna objektive dhe të verifikueshme, e jo në vlerësime subjektive.

Rëndësia e monitorimit mjedisor është veçanërisht e theksuar në sektorët ku ndryshimet ndodhin me ritme të shpejta ose ku ndikimet në shëndetin e popullatës dhe në ekosisteme janë të drejtpërdrejta. Monitorimi i cilësisë së ajrit mundëson identifikimin e tejkalimeve të vlerave kufitare të ndotësve atmosferikë dhe vlerësimin e ekspozimit të popullsisë ndaj tyre. Në mënyrë të ngjashme, monitorimi i cilësisë së ujërave ndihmon në identifikimin e burimeve të ndotjes dhe mbështet planifikimin e masave për mbrojtjen e burimeve ujore. Ndërkohë, monitorimi i biodiversitetit kontribuon në vlerësimin e gjendjes së habitateve natyrore dhe specieve të mbrojtura, duke ofruar bazën shkencore për planifikimin e masave të ruajtjes së natyrës.

Në nivel institucional, monitorimi mjedisor forcon transparencën, llogaridhënien dhe cilësinë e qeverisjes. Raportet periodike mbi gjendjen e mjedisit u mundësojnë institucioneve publike të vlerësojnë progresin në zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit, ndërsa njëkohësisht informojnë qytetarët, komunitetin shkencor dhe palët e tjera të interesit mbi gjendjen reale të mjedisit. Për më tepër, raportimi sistematik është një element i rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe për harmonizimin gradual të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian.

Efektiviteti i monitorimit mjedisor varet nga funksionimi i një sistemi të mirëorganizuar institucional, ekzistenca e metodologjive të standardizuara,

kapacitetet profesionale dhe teknike, përdorimi i sistemeve moderne për menaxhimin e të dhënave, si dhe koordinimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Mungesa e standardizimit të metodave të monitorimit, kapacitetet e kufizuara institucionale ose shkëmbimi jo i plotë i të dhënave mund të ndikojnë negativisht në cilësinë, besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e informacionit mjedisor. Për këtë arsye, zhvillimi dhe zbatimi i një metodologjie të unifikuar për monitorimin dhe raportimin mjedisor përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të qeverisjes mjedisore, rritjes së transparencës institucionale dhe përmirësimit të procesit të vendimmarrjes në Republikën e Kosovës.

1.3 Monitorimi mjedisor në kuadër të politikave të Bashkimit Evropian

Monitorimi mjedisor përbën një nga shtyllat themelore të politikës së mjedisit të Bashkimit Evropian dhe shërben si mekanizëm për mbledhjen, analizimin, interpretimin dhe raportimin e të dhënave mbi gjendjen e mjedisit në vendet anëtare dhe partnerët evropianë. Sistemi evropian i monitorimit mbështetet në indikatorë të harmonizuar, metodologji të standardizuara dhe sisteme të integruara të informacionit mjedisor, të cilat sigurojnë krahasueshmërinë e të dhënave ndërmjet shteteve dhe mundësojnë vlerësimin e progresit në arritjen e objektivave të politikave mjedisore të Bashkimit Evropian. Një rol qendror në këtë sistem ka Agjencia Evropiane e Mjedisit (European Environment Agency - EEA), e cila, përmes Rrjetit Evropian për Informacion dhe Vëzhgim Mjedisor (European Environment Information and Observation Network – EIONET), koordinon mbledhjen, shkëmbimin dhe harmonizimin e informacionit mjedisor në nivel evropian.

Sipas raportit *Mjedisi i Evropës 2025 – Profili i Kosovës*, vlerësimi i progresit të Republikës së Kosovës mbështetet në një grup prej 20 treguesish të

harmonizuar, të zhvilluar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit dhe Eurostat. Këta tregues mbulojnë tri fusha kryesore: gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, zhvillimet socio-ekonomike dhe transformimin e sistemeve të energjisë, transportit dhe ushqimit. Përdorimi i këtyre indikatorëve mundëson krahasimin e performancës së Kosovës me vendet e tjera evropiane dhe identifikimin e prioriteteve për përmirësimin e politikave dhe masave mjedisore.

Raporti evidenton se Kosova ka shënuar progres në disa sektorë të mbrojtjes së mjedisit, përfshirë rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, zgjerimin e sipërfaqeve të mbrojtura dhe përmirësimin gradual të disa treguesve mjedisorë. Megjithatë, mbeten sfida të rëndësishme në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, transformimin e sektorit energjetik, zhvillimin e ekonomisë qarkore, përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Raporti thekson gjithashtu se pyjet përfaqësojnë rezervuarin kryesor të karbonit në vend, ndërsa sektori i energjisë vazhdon të jetë burimi kryesor i emetimeve të gazeve serrë.

Në kuadër të politikave të Bashkimit Evropian, monitorimi mjedisor nuk kufizohet vetëm në mbledhjen e të dhënave, por përbën një instrument thelbësor për vlerësimin e zbatimit të politikave publike dhe matjen e progresit drejt objektivave strategjike të Bashkimit Evropian, si tranzicioni drejt një ekonomie me emetime të ulëta të karbonit, mbrojtja e biodiversitetit, përdorimi efikas i burimeve natyrore dhe zhvillimi i ekonomisë qarkore. Për këtë arsye, të dhënat mjedisore duhet të jenë të sakta, të besueshme, të krahasueshme dhe të harmonizuara me standardet evropiane, në mënyrë që të mbështesin raportimin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe procesin e vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

Për Republikën e Kosovës, harmonizimi gradual i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor me standardet e Bashkimit Evropian përfaqëson një komponent të rëndësishëm të procesit të integritit evropian. Bashkëpunimi me Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe pjesëmarrja në rrjetin EIONET kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e metodologjive të monitorimit, zhvillimin e sistemeve të informacionit mjedisor dhe rritjen e cilësisë së raportimit. Këto procese krijojnë bazën për prodhimin e të dhënave të besueshme, rritjen e transparencës institucionale dhe përmbushjen graduale të kërkesave të Bashkimit Evropian në fushën e monitorimit dhe raportimit mjedisor.

1.4 Sistemi institucional i monitorimit mjedisor në Republikën e Kosovës

Sistemi institucional i monitorimit dhe raportimit mjedisor në Republikën e Kosovës është ndërtuar mbi një strukturë të institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore, monitorimin e komponentëve të mjedisit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, raportimin mbi gjendjen e mjedisit, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Ky sistem funksionon në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe institucioneve të saj vartëse, në veçanti Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHK) dhe Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), si dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë kompetenca specifike në sektorin e mjedisit. Organizimi institucional mundëson monitorimin sistematik të komponentëve kryesorë të mjedisit dhe përgatitjen e raporteve periodike mbi gjendjen e tij.

Sipas Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, i publikuar në tetor 2025, funksionimi i institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit përbën një element thelbësor të sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor. Në këtë kuadër analizohen organizimi institucional, struktura organizative e Ministrisë së Mjedisit dhe e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, bashkëpunimi me Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) dhe Rrjetin Evropian për Informacion dhe Vëzhgim Mjedisor (EIONET), si dhe organizimi i shërbimeve mjedisore dhe inspektuese në nivel lokal. Këta elementë përbëjnë bazën institucionale për sigurimin e funksionimit të sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Në kuadër të reformës së administratës publike, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka realizuar riorganizimin e strukturës së saj përmes Rregullores (ZKM) Nr. 08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës. Ky proces synon forcimin e kapaciteteve administrative, qartësimin e kompetencave institucionale dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, duke rritur efikasitetin e monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Një rol qendror në këtë sistem ushtron Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), e cila është institucioni përgjegjës për monitorimin e gjendjes së mjedisit, administrimin e informacionit mjedisor dhe përgatitjen e raporteve kombëtare mbi gjendjen e mjedisit. Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024 evidenton procesin e riorganizimit të Agjencisë si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të cilësisë së monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Një komponent i rëndësishëm i sistemit institucional është bashkëpunimi me Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) dhe rrjetin EIONET, i cili mundëson

harmonizimin e metodologjive të monitorimit, shkëmbimin e informacionit mjedisor dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave sipas standardeve evropiane. Përmes këtij bashkëpunimi forcohen kapacitetet institucionale për raportim, zhvillohen sistemet kombëtare të informacionit mjedisor dhe rritet krahasueshmëria e të dhënave të Republikës së Kosovës me ato të vendeve të Bashkimit Evropian.

Përveç institucioneve të nivelit qendror, funksionimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor mbështetet edhe nga zyrtarët komunalë për mjedis dhe inspektorët mjedisorë, të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor, evidentimin e problematikave në terren dhe raportimin e tyre pranë institucioneve kompetente. Bashkëpunimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal është një parakusht për sigurimin e një sistemi funksional të monitorimit dhe raportimit mjedisor, i cili garanton prodhimin e të dhënave të besueshme dhe mbështet vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

1.5 Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë sistemin e monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës, përmes analizës së organizimit institucional, kornizës ligjore, kapaciteteve njerëzore dhe teknike, praktikave të monitorimit, proceseve të raportimit dhe bashkëpunimit ndërinstitutional. Përmes kësaj analize synohet të paraqitet një pasqyrë e qartë mbi funksionimin e sistemit aktual të monitorimit mjedisor, duke evidentuar nivelin e zhvillimit të mekanizmave institucionalë, sfidat ekzistuese dhe mundësitë për përmirësimin e tyre në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë mjedisore.

Hartimi i këtij raporti është mbështetur në analizën e pyetësorëve të plotësuar nga institucionet qendrore përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin

mjedisor, përkatësisht Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Përmes këtyre pyetësorëve janë mbledhur të dhëna mbi organizimin institucional, bazën ligjore, kapacitetet administrative dhe teknike, sistemet e monitorimit, menaxhimin e të dhënave, proceset e raportimit dhe format e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Për të siguruar një analizë objektive dhe të bazuar në evidencë, rezultatet e pyetësorëve janë krahasuar dhe plotësuar me informacionin e paraqitur në dokumentet zyrtare të sektorit të mjedisit, veçanërisht Raportin Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, Raportin për Gjendjen e Ajrit 2025, Mjedisi i Evropës 2025 – Profili i Kosovës, si dhe dokumente të tjera të publikuara nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Kjo qasje metodologjike mundëson verifikimin e informacionit të siguruar nga institucionet, rrit besueshmërinë e analizës dhe ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi funksionimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në nivel qendror.

Raporti identifikon pikat e forta të sistemit ekzistues, boshllëqet institucionale dhe operacionale, si dhe sfidat që ndikojnë në cilësinë e monitorimit dhe raportimit mjedisor. Njëkohësisht, analizon nivelin e koordinimit ndërinstitutional, shkallën e standardizimit të proceseve të monitorimit dhe menaxhimit të të dhënave, si dhe kapacitetin e institucioneve për të prodhuar informacion mjedisor të besueshëm, të krahasueshëm dhe të përdorshëm në hartimin dhe zbatimin e politikave publike.

Nëpërmjet analizës së kryer dhe rekomandimeve të propozuara, ky raport synon të kontribuojë në forcimin e sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor, përmirësimin e koordinimit ndërinstytucional, rritjen e cilësisë së të dhënave mjedisore dhe mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë. Gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura pritet të shërbejnë si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave institucionale të monitorimit dhe raportimit mjedisor, si dhe për avancimin e qeverisjes mjedisore në Republikën e Kosovës.

1.6 Objektivat e raportit

Për arritjen e qëllimit të përgjithshëm të këtij raporti janë përcaktuar objektivat specifike në vijim:

- Të analizohet korniza institucionale dhe organizative e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës.
- Të vlerësohen rolet, përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve qendrore përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mjedisor.
- Të identifikohen kapacitetet institucionale, administrative, njerëzore dhe teknike të institucioneve përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve të monitorimit dhe raportimit mjedisor.
- Të vlerësohet funksionaliteti i sistemeve ekzistuese të monitorimit mjedisor, duke përfshirë monitorimin e cilësisë së ajrit, ujërave, tokës, biodiversitetit, mbeturinave dhe komponentëve të tjerë të mjedisit, në përputhje me kompetencat institucionale.
- Të analizohet mënyra e mbledhjes, përpunimit, menaxhimit, ruajtjes dhe shkëmbimit të të dhënave mjedisore ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

- Të vlerësohet funksionimi i mekanizmave të raportimit mjedisor, si dhe niveli i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional në procesin e monitorimit dhe raportimit.
- Të analizohet përputhshmëria e praktikave ekzistuese të monitorimit dhe raportimit me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare dhe kërkesat e Bashkimit Evropian në fushën e monitorimit dhe raportimit mjedisor.
- Të identifikohen sfidat, boshllëqet dhe nevojat për përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore.
- Të krahasohen gjetjet e pyetësorëve të institucioneve qendrore me informacionin e paraqitur në raportet dhe dokumentet zyrtare të institucioneve përgjegjëse, me qëllim verifikimin dhe plotësimin e analizës.
- Të formulohen rekomandime konkrete dhe të zbatueshme për forcimin e kapaciteteve institucionale, standardizimin e proceseve të monitorimit dhe raportimit, përmirësimin e koordinimit ndërinstytucional, zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të të dhënave mjedisore dhe mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1 Qasja metodologjike

Ky raport është hartuar duke përdorur një qasje cilësore (qualitative research approach), e cila është mbështetur në analizën dokumentare dhe analizën e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve të strukturuar, të plotësuar nga institucionet qendrore përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mjedisor në Republikën e Kosovës. Përdorimi i kësaj qasjeje ka mundësuar vlerësimin e organizimit institucional, kapaciteteve administrative dhe teknike, praktikave ekzistuese të monitorimit, proceseve të raportimit dhe nivelit të bashkëpunimit ndërinstitutional në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Për të siguruar një analizë gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në evidencë, informacioni i siguruar përmes pyetësorëve është krahasuar dhe plotësuar me të dhënat e publikuara në dokumentet zyrtare të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe burime të tjera relevante të përdorura në këtë raport. Kjo qasje metodologjike ka mundësuar verifikimin e informacionit të marrë nga institucionet pjesëmarrëse, identifikimin e përputhshmërisë ndërmjet praktikave institucionale dhe dokumentacionit zyrtar, si dhe rritjen e besueshmërisë së rezultateve të analizës.

Në hartimin e raportit është përdorur edhe metoda e analizës krahasuese (comparative analysis), përmes së cilës janë krahasuar përgjigjet e institucioneve pjesëmarrëse me informacionin e paraqitur në raportet dhe dokumentet zyrtare të sektorit të mjedisit. Kjo metodë ka shërbyer për identifikimin e praktikave ekzistuese, evidentimin e boshllëqeve institucionale, vlerësimin e sfidave operative dhe analizimin e mundësive për përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore.

Qasja metodologjike e përdorur kombinon analizën institucionale me analizën dokumentare dhe krahasuese, duke mundësuar një vlerësim sistematik të organizimit, funksionimit dhe efektivitetit të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor. Kjo qasje ka shërbyer si bazë për identifikimin e gjetjeve kryesore dhe formulimin e rekomandimeve të paraqitura në kapitujt vijues të raportit.

2.2 Burimet e të dhënave

Për hartimin e këtij raporti janë përdorur burime primare dhe burime sekondare të të dhënave, me qëllim sigurimin e një analize gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe të bazuar në evidencë.

Burimet primare përbëhen nga të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve të strukturuar, të plotësuar nga institucionet qendrore përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mjedisor në Republikën e Kosovës. Pyetësorët janë hartuar për të mbledhur informacion mbi organizimin institucional, kornizën ligjore, kapacitetet njerëzore dhe teknike, sistemet e monitorimit, menaxhimin e të dhënave mjedisore, mekanizmat e raportimit, bashkëpunimin ndërinstitutional, si dhe sfidat dhe nevojat e institucioneve në ushtrimin e kompetencave të tyre.

Burimet sekondare përfshijnë dokumentet dhe publikimet zyrtare të përdorura për verifikimin, plotësimin dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve. Dokumentet kryesore të përdorura në këtë raport janë:

- Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK);
- Raporti për Gjendjen e Ajrit 2025, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

- Mjedis i Evropës 2025 – Profili i Kosovës, Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA) dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Raporti mbi përdorimin e qeseve plastike në Republikën e Kosovës, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Ligjet, aktet nënligjore dhe dokumentet strategjike në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Publikime dhe dokumente të tjera zyrtare të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mjedisor.

Kombinimi i burimeve primare dhe sekondare ka mundësuar verifikimin e informacionit, krahasimin e praktikave institucionale me dokumentacionin zyrtar dhe zhvillimin e një analize të bazuar në evidencë mbi funksionimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës.

2.3 Instrumentet e mbledhjes së të dhënave

Instrumenti kryesor i përdorur për mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim ishte pyetësi i strukturuar, i hartuar posaçërisht për institucionet qendrore përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mjedisor në Republikën e Kosovës. Pyetësi është zhvilluar në kuadër të Metodologjisë për Monitorimin dhe Raportimin Mjedisor të hartuar nga EC Ma Ndryshe, me qëllim sigurimin e një qasjeje të standardizuar për mbledhjen e informacionit dhe mundësimin e analizës krahasuese ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse. (*EC Ma Ndryshe, 2025*).

Pyetësi është konceptuar për të mbledhur në mënyrë sistematike informacion mbi organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit

mjedisor, duke mbuluar aspektet institucionale, ligjore, administrative dhe teknike të këtij sistemi. Struktura e tij është ndërtuar në mënyrë që të mundësojë jo vetëm përshkrimin e praktikave ekzistuese, por edhe identifikimin e kapaciteteve, sfidave dhe nevojave për përmirësim në institucionet përgjegjëse.

Përmbajtja e pyetësit është organizuar në kapituj tematikë që trajtojnë:

- organizimin institucional;
- kornizën ligjore;
- kapacitetet njerëzore dhe teknike;
- dokumentet e planifikimit dhe programet mjedisore;
- sistemet e monitorimit mjedisor;
- menaxhimin e të dhënave mjedisore;
- mekanizmat e raportimit mjedisor;
- bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitutional;
- sfidat, kufizimet dhe nevojat për përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Përdorimi i një pyetësi me strukturë të unifikuar ka mundësuar mbledhjen e të dhënave në një format të standardizuar, duke krijuar kushte për krahasimin e përgjigjeve ndërmjet institucioneve dhe identifikimin e ngjashmërive dhe dallimeve në organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor. Njëkohësisht, kjo qasje ka lehtësuar analizën krahasuese dhe ka rritur objektivitetin e gjetjeve të paraqitura në këtë raport.

Përveç pyetësit, gjatë procesit të analizës janë shfrytëzuar edhe dokumente zyrtare për verifikimin dhe plotësimin e informacionit të marrë nga institucionet. Kombinimi i këtyre instrumenteve ka kontribuar në rritjen e besueshmërisë së rezultateve dhe në zhvillimin e një analize të bazuar në evidencë mbi sistemin e monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës.

2.4 Institucionet e përfshira në hulumtim

Hulumtimi është realizuar në bashkëpunim me institucionet qendrore përgjegjëse për monitorimin, raportimin dhe mbikëqyrjen e gjendjes së mjedisit në Republikën e Kosovës. Përzgjedhja e institucioneve është bërë mbi bazën e kompetencave të tyre ligjore dhe rolit që ushtrojnë në funksionimin e sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor. Përfshirja e institucioneve me mandate të ndryshme ka mundësuar analizimin e sistemit nga perspektiva institucionale, teknike dhe mbikëqyrëse, duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të organizimit dhe funksionimit të tij.

Institucionet e përfshira në këtë hulumtim janë:

- Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), përgjegjës për monitorimin e biodiversitetit, habitateve natyrore, zonave të mbrojtura dhe vlerave të trashëgimisë natyrore;
- Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), përgjegjës për monitorimin e gjendjes së mjedisit, përgatitjen e raporteve kombëtare mjedisore, administrimin e informacionit mjedisor dhe koordinimin e raportimit mjedisor;

- Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor, kryerjen e inspektimeve dhe kontrollin e respektimit të kushteve të përcaktuara në legjislacionin dhe lejet mjedisore.

Përfshirja e këtyre institucioneve ka mundësuar analizimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor nga këndvështrime të ndryshme institucionale, duke përfshirë monitorimin e komponentëve të mjedisit, raportimin e gjendjes së mjedisit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor. Kjo qasje ka kontribuar në krijimin e një analize më gjithëpërfshirëse dhe në formulimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të bazuara në kompetencat dhe përvojat praktike të institucioneve përgjegjëse.

2.5 Metoda e analizës

Analiza e të dhënave është realizuar duke kombinuar analizën cilësore (qualitative analysis) me analizën krahasuese (comparative analysis), me qëllim vlerësimin e funksionimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës. Kjo qasje metodologjike ka mundësuar interpretimin e informacionit të mbledhur përmes pyetësorëve dhe krahasimin e tij me të dhënat e publikuara në dokumentet zyrtare të institucioneve përgjegjëse.

Për jedisi institucion pjesëmarrës është realizuar një analizë sistematike, duke u fokusuar në elementet kryesore të funksionimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor, përkatësisht:

- organizimin institucional;

- kompetencat ligjore;
- kapacitetet administrative, njerëzore dhe teknike;
- dokumentet e planifikimit dhe programet mjedisore;
- sistemet ekzistuese të monitorimit mjedisor;
- menaxhimin e të dhënave mjedisore;
- mekanizmat e raportimit mjedisor;
- bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitutional;
- sfidat, kufizimet dhe nevojat për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit.

Në vijim, rezultatet e përftuara nga pyetësorët janë krahasuar me informacionin e publikuar në Raportin Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, Raportin për Gjendjen e Ajrit 2025, Mjedisi I Evropës 2025 – Profili I Kosovës, si dhe dokumente të tjera zyrtare të Agjencisë për Mbrojtjen e mjedisit të Kosovës, me qëllim verifikimin e të dhënave, identifikimin e përputhshmërisë ndërmjet praktikave institucionale dhe dokumentacionit zyrtar, si dhe evidentimin e boshllëqeve dhe sfidave ekzistuese. (AMMK, 2025; EEA & AMMK, 2025).

Interpretimi i rezultateve është mbështetur në analizën profesionale të informacionit të mbledhur, duke ruajtur integritetin e përgjigjeve të institucioneve pjesëmarrëse dhe duke shmangur nxjerrjen e përfundimeve që nuk mbështeten në evidencën e disponueshme. Përfundimet dhe rekomandimet e raportit janë formuluar ekskluzivisht mbi bazën e të dhënave të mbledhura dhe dokumentacionit zyrtar të analizuar, me synimin për të siguruar objektivitet, besueshmëri dhe transparencë në procesin e hulumtimit.

2.6 Kufizimet e hulumtimit

Si çdo hulumtim, edhe ky raport paraqet kufizime të caktuara metodologjike që duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të rezultateve.

Rezultatet e analizës mbështeten në informacionin e siguruar nga institucionet pjesëmarrëse përmes pyetësorëve të strukturuar dhe në dokumentet zyrtare të disponueshme gjatë periudhës së realizimit të hulumtimit. Për rrjedhojë, cilësia dhe plotësia e analizës varen nga saktësia, përditësimi dhe niveli i detajimit të informacionit të ofruar nga institucionet dhe nga dokumentacioni zyrtar i përdorur si burim reference.

Fushëveprimi i hulumtimit është kufizuar në institucionet qendrore që ushtrojnë kompetenca në monitorimin, raportimin dhe mbikëqyrjen e gjendjes së mjedisit në Republikën e Kosovës. Për këtë arsye, analiza nuk përfshin institucionet e nivelit lokal, institucionet e tjera sektoriale apo organizatat e tjera që mund të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në sistemin kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Gjithashtu, raporti nuk synon të vlerësojë performancën individuale të institucioneve pjesëmarrëse, por funksionimin e përgjithshëm të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor, bazuar në informacionin e mbledhur dhe në analizën e dokumenteve zyrtare. Për këtë arsye, gjetjet dhe përfundimet duhet të interpretohen në kontekstin e objektivave të këtij hulumtimi.

Rezultatet e paraqitura pasqyrojnë gjendjen e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në periudhën gjatë së cilës është realizuar hulumtimi. Çdo ndryshim i mëvonshëm në organizimin institucional, legjislacionin mjedisor, strukturat administrative ose sistemet e monitorimit mund të ndikojë në vlefshmërinë e disa prej gjetjeve dhe përfundimeve të raportit.

Megjithëse këto kufizime janë marrë në konsideratë gjatë procesit të analizës, kombinimi i të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve me dokumentacionin zyrtar të institucioneve përgjegjëse ka kontribuar në rritjen e besueshmërisë së rezultateve dhe në zhvillimin e një analize sa më objektive dhe të bazuar në evidencë.

3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

3.1 Korniza ligjore për monitorimin dhe raportimin mjedisor

Sistemi i monitorimit dhe raportimit mjedisor në Republikën e Kosovës mbështetet në një kornizë ligjore të ndërtuar mbi ligje, akte nënligjore dhe dokumente strategjike që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit, monitorimin e komponentëve të tij, menaxhimin e informacionit mjedisor dhe raportimin periodik mbi gjendjen e mjedisit. Kjo kornizë synon të sigurojë zbatimin efektiv të politikave mjedisore, mbrojtjen e burimeve natyrore, përdorimin e qëndrueshëm të tyre dhe harmonizimin gradual të legjislacionit kombëtar me *acquis* të Bashkimit Evropian.

Baza ligjore e sistemit mbështetet kryesisht në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili përcakton parimet themelore të mbrojtjes së mjedisit, përgjegjësitë institucionale dhe detyrimin për monitorimin sistematik të gjendjes së mjedisit. Ky ligj plotësohet nga një sërë ligjesh sektoriale, ndër të cilat Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat dhe Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet, të cilat përcaktojnë kërkesa specifike për monitorimin, mbikëqyrjen dhe raportimin në sektorët përkatës.

Përveç legjislacionit parësor, funksionimi i sistemit mbështetet edhe në akte nënligjore dhe dokumente strategjike që rregullojnë metodologjitë e monitorimit, procedurat e raportimit, organizimin institucional dhe administrimin e të dhënave mjedisore. Një ndër dokumentet më të rëndësishme në këtë drejtim është Rregullorja (ZKM) Nr. 08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila synon forcimin e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.

Sipas Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, gjatë vitit 2024 kanë vazhduar aktivitetet për hartimin, plotësimin dhe harmonizimin e legjislacionit mjedisor me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Raporti evidenton se procesi i përafrimit me *acquis* përfshin jo vetëm miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore, por edhe zhvillimin e mekanizmave institucionalë dhe metodologjikë për monitorimin dhe raportimin mjedisor në përputhje me standardet evropiane.

Korniza ligjore mbështetet gjithashtu në dokumente strategjike dhe programe kombëtare që përcaktojnë objektivat, prioritetet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin e sistemeve të monitorimit. Këto dokumente krijojnë bazën për standardizimin e metodologjive të monitorimit, prodhimin e të dhënave të krahasueshme dhe hartimin e raporteve periodike mbi gjendjen e mjedisit në Republikën e Kosovës.

Përveç legjislacionit kombëtar, zhvillimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor ndikohet edhe nga obligimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare në fushën e mjedisit. Në këtë kuadër, bashkëpunimi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) dhe Rrjetin Evropian për

Informacion dhe Vëzhgim Mjedisor (EIONET) kontribuon në harmonizimin e metodologjive të monitorimit, rritjen e cilësisë së të dhënave mjedisore dhe avancimin e raportimit sipas standardeve evropiane.

3.2 Organizimi institucional i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor

Organizimi institucional i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në Republikën e Kosovës është ndërtuar mbi një strukturë të institucioneve qendrore, të cilat ushtrojnë kompetenca të ndërlidhura në hartimin e politikave mjedisore, monitorimin e komponentëve të mjedisit, menaxhimin e të dhënave mjedisore, raportimin periodik mbi gjendjen e mjedisit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit. Funksionimi i këtij sistemi mbështetet në bashkëpunimin ndërinstitutional dhe në ndarjen e qartë të përgjegjësiave ndërmjet institucioneve kompetente.

Institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në sektorin e mjedisit është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Ministria koordinon zhvillimin e politikave dhe legjislacionit mjedisor, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe siguron koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë vitit 2024 është realizuar riorganizimi i Ministrisë përmes Rregullores (ZKM) Nr. 08/2024, me qëllim të rritjes së efikasitetit institucional dhe forcimit të kapaciteteve administrative në sektorin e mjedisit.

Në kuadër të MMPHI-së funksionon Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), e cila përfaqëson institucionin kryesor teknik dhe shkencor përgjegjës për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit. AMMK mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat mjedisore nga sektorë të ndryshëm, harton Raportin Vjetor për Gjendjen e Mjedisit dhe raporte të tjera

tematike, si dhe zhvillon dhe mirëmban sistemet e informacionit mjedisor. Për më tepër, Agjencia koordinon raportimin e të dhënave mjedisore në kuadër të bashkëpunimit me Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) dhe rrjetin EIONET.

Brenda strukturës së AMMK-së, një rol të rëndësishëm kanë njësitë përgjegjëse për monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjen e natyrës. Në këtë kuadër, Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit është përgjegjës për mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave mjedisore, përgatitjen e raporteve tematike dhe zhvillimin e indikatorëve mjedisorë, ndërsa Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) ushtron kompetenca në monitorimin e biodiversitetit, habitateve natyrore dhe zonave të mbrojtura, si dhe në përgatitjen e dokumentacionit profesional për ruajtjen e trashëgimisë natyrore.

Një komponent tjetër i rëndësishëm i sistemit institucional është Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHKM), i cili realizon monitorimin e parametrave hidrologjikë, meteorologjikë dhe të cilësisë së ujërave, si dhe siguron të dhëna të rëndësishme për vlerësimin e gjendjes së mjedisit. Të dhënat e prodhuara nga IHMK përdoren në përgatitjen e raporteve zyrtare mbi gjendjen e mjedisit dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të sistemit kombëtar të monitorimit mjedisor.

Përveç institucioneve përgjegjëse për monitorimin, sistemi institucional përfshin edhe strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor. Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor ushtron funksionin e kontrollit administrativ dhe inspektues, duke mbikëqyrur zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, natyrës dhe burimeve natyrore. Veprimtaria e tij plotëson sistemin e monitorimit përmes evidentimit të shkeljeve, marrjes së masave administrative dhe kontribuon në zbatimin efektiv të legjislacionit mjedisor.

Për funksionimin efikas të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor është thelbësor bashkëpunimi ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse. Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024 evidenton rëndësinë e koordinimit institucional, zhvillimit të sistemeve të integruara të informacionit mjedisor, shkëmbimit të të dhënave dhe bashkëpunimit me institucionet evropiane, si parakushte për përmirësimin e cilësisë së monitorimit dhe raportimit mjedisor në Republikën e Kosovës.

3.3 Raportimi mjedisor në Republikën e Kosovës

Raportimi mjedisor përbën një nga funksionet kryesore të sistemit kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe ka për qëllim sigurimin e informacionit të besueshëm, të standardizuar dhe të përditësuar mbi gjendjen e komponentëve të mjedisit. Përmes raportimit periodik, institucionet përgjegjëse informojnë organet vendimmarrëse, institucionet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe publikun për gjendjen e mjedisit, ndryshimet e evidentuara dhe rezultatet e monitorimit të realizuar gjatë periudhës raportuese. Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit përfaqëson dokumentin kryesor kombëtar të raportimit mjedisor në Republikën e Kosovës.

Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024 është përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës në përputhje me mandatin e saj institucional dhe ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi gjendjen e mjedisit në vend. Dokumenti trajton gjendjen dhe trendet e komponentëve kryesorë të mjedisit, përfshirë cilësinë e ajrit, ujërave, tokës, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, ndikimet në shëndetin e popullatës, gjendjen e zonave të rrezikuara, zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit, masat për mbrojtjen e mjedisit, funksionimin e institucioneve dhe financimin e sektorit

mjedisor. Kjo strukturë mundëson një vlerësim të integruar të gjendjes së mjedisit dhe të progresit të arritur në sektorin e mjedisit.

Raportimi mjedisor mbështetet në të dhënat e siguruar nga institucionet përgjegjëse për monitorimin e komponentëve të ndryshëm të mjedisit. Në procesin e hartimit të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit përfshihen të dhëna të mbledhura nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, ministritë përkatëse, komunat dhe institucione të tjera publike që disponojnë të dhëna relevante për sektorin e mjedisit. Bashkimi i këtyre burimeve mundëson përgatitjen e një raporti të bazuar në të dhëna zyrtare dhe të verifikueshme.

Përveç raportit vjetor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës publikon edhe raporte tematike që trajtojnë sektorë të veçantë të monitorimit mjedisor. Këto përfshijnë, ndër të tjera, raportet për gjendjen e cilësisë së ajrit, raportet për emetimet e gazeve serrë, raportet mbi përdorimin e qeseve plastike dhe publikime të tjera tematike që kontribuojnë në monitorimin dhe raportimin e vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit në Republikën e Kosovës. Këto dokumente plotësojnë raportimin vjetor dhe ofrojnë analiza më të detajuara për fusha specifike të monitorimit mjedisor.

Një komponent i rëndësishëm i raportimit mjedisor është edhe raportimi ndërkombëtar. Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024 evidenton bashkëpunimin e vazhdueshëm të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) dhe Rrjetin Evropian për Informacion dhe Vëzhgim Mjedisor (EIONET). Ky bashkëpunim mundëson harmonizimin e metodologjive të raportimit, përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe

raportimin sipas standardeve evropiane, duke kontribuar në krahasueshmërinë e informacionit mjedisor të Kosovës me vendet e tjera evropiane.

Raportimi i rregullt dhe i standardizuar i të dhënave mjedisore përbën një element thelbësor për mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë, hartimin e politikave publike, vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra dhe rritjen e transparencës institucionale. Në të njëjtën kohë, ai krijon bazën për identifikimin e sfidave mjedisore, përcaktimin e prioritetëve strategjike dhe planifikimin e masave të ardhshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Republikën e Kosovës.

3.4 Harmonizimi me *acquis* të Bashkimit Evropian

Harmonizimi i legjislacionit dhe praktikave të monitorimit e raportimit mjedisor me *acquis* të Bashkimit Evropian përbën një nga objektivat kryesore të sektorit të mjedisit në Republikën e Kosovës. Në kuadër të procesit të integritetit evropian, institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë hapa për përafrimin e legjislacionit kombëtar, zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe raportimit, me qëllim përmbushjen graduale të standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian.

Raporti "Mjedi i Evropës 2025 - Profili i Kosovës" thekson se progresi i Kosovës në fushën e mjedisit vlerësohet përmes një grupi treguesish të harmonizuar të zhvilluar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA) dhe Eurostat. Këta tregues mbulojnë fusha të ndryshme të mjedisit, ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke mundësuar krahasimin e performancës së Kosovës me vendet e tjera evropiane dhe identifikimin e prioritetëve për përmirësim.

Në raport evidentohet se, megjithëse Kosova ka shënuar progres në disa sektorë të mjedisit, mbeten sfida të rëndësishme që lidhen me ndotjen e ajrit,

menaxhimin e mbeturinave, tranzicionin energjetik, mbrojtjen e biodiversitetit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Për këtë arsye, forcimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor konsiderohet një ndër parakushtet kryesore për hartimin e politikave efektive dhe për matjen e progresit në zbatimin e objektivave mjedisore të Bashkimit Evropian.

Një element i rëndësishëm i harmonizimit është bashkëpunimi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) dhe Rrjetin Evropian për Informacion dhe Vëzhgim Mjedisor (EIONET). Sipas Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024, ky bashkëpunim kontribuon në përmirësimin e cilësisë së të dhënave mjedisore, harmonizimin e metodologjive të monitorimit, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmbushjen e detyrimeve të raportimit sipas standardeve evropiane. Përmes këtij procesi, institucionet e Kosovës përfshihen në rrjetet evropiane të shkëmbimit të informacionit mjedisor dhe avancojnë gradualisht sistemin kombëtar të monitorimit dhe raportimit.

Harmonizimi me *acquis* të Bashkimit Evropian nuk kufizohet vetëm në përafrimin e legjislacionit, por përfshin edhe zhvillimin e metodologjive të standardizuara të monitorimit, përmirësimin e sistemeve të informacionit mjedisor, përdorimin e indikatorëve të krahasueshëm dhe rritjen e cilësisë së raportimit. Këta elementë janë thelbësorë për prodhimin e të dhënave të besueshme dhe të krahasueshme, të cilat mbështesin vendimmarrjen, raportimin kombëtar dhe bashkëpunimin me institucionet evropiane në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

4. ANALIZA E SISTEMIT TË MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT MJEDISOR NË ADMINISTRATËN QENDRORE

Ky kapitull paraqet analizën e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës, bazuar në të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve të strukturuar të plotësuar nga institucionet përgjegjëse në këtë fushë. Analiza është mbështetur në një qasje krahasuese dhe interpretuese, me qëllim vlerësimin e organizimit institucional, kapaciteteve administrative dhe teknike, praktikave ekzistuese të monitorimit dhe raportimit, si dhe identifikimin e sfidave që ndikojnë në funksionimin e sistemit.

Në hulumtim janë përfshirë tri institucione qendrore me kompetenca të ndryshme, por komplementare në sistemin kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor: Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Përfshirja e këtyre institucioneve ka mundësuar analizimin e sistemit nga këndvështrime të ndryshme funksionale, duke përfshirë monitorimin e gjendjes së mjedisit, mbrojtjen e natyrës, raportimin mjedisor dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Analiza është organizuar sipas fushave tematike të pyetësorit dhe trajton organizimin institucional, kapacitetet njerëzore dhe teknike, kornizën ligjore, dokumentet e planifikimit, sistemet e monitorimit, menaxhimin e të dhënave mjedisore, mekanizmat e raportimit, bashkëpunimin ndërinstitutional, si dhe

aspektet që lidhen me licencimin dhe lejet mjedisore. Një strukturë e tillë mundëson krahasimin horizontal të praktikave institucionale, evidentimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet institucioneve, si dhe vlerësimin e nivelit të zhvillimit të sistemit në tërësi.

Gjetjet e paraqitura në këtë kapitull mbështeten ekskluzivisht në informacionin e siguruar nga institucionet pjesëmarrëse dhe në dokumentet zyrtare të analizuara në kuadër të hulumtimit. Interpretimi i rezultateve është realizuar në përputhje me qasjen metodologjike të paraqitur në kapitullin paraprak, duke ruajtur objektivitetin e analizës dhe duke shmangur nxjerrjen e përfundimeve që nuk mbështeten në evidencën e disponueshme.

Rezultatet e analizës ofrojnë një pasqyrë të nivelit aktual të zhvillimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore, evidentojnë kapacitetet ekzistuese, sfidat dhe boshllëqet institucionale, si dhe krijojnë bazën për formulimin e rekomandimeve të paraqitura në pjesën përmbyllëse të raportit.

4.1 Skema institucionale dhe kapacitetet njerëzore

Kapacitetet institucionale dhe njerëzore përbëjnë një nga faktorët përcaktues për funksionimin efektiv të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor. Efikasiteti i këtij sistemi varet jo vetëm nga ekzistenca e një kornize të përshtatshme ligjore dhe organizative, por edhe nga disponueshmëria e burimeve njerëzore me kualifikim profesional dhe kompetenca të përshtatshme për realizimin e detyrave institucionale. Analiza e përgjigjeve të institucioneve pjesëmarrëse tregon se, pavarësisht dallimeve në mandatet dhe përgjegjësitë e tyre, ekziston një qëndrim i përbashkët se kapacitetet aktuale njerëzore nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) vlerëson se jo të gjitha strukturat organizative të parapara janë themeluar dhe se numri aktual i shërbyesve civil nuk është i mjaftueshëm për realizimin e kompetencave të institutit. Gjithashtu, institucioni konsideron se profilet profesionale janë vetëm pjesërisht të përshtatshme për nevojat aktuale dhe e ka vlerësuar nivelin e përgatitjes profesionale të stafit me 2 nga 5. Këto rezultate tregojnë nevojën për plotësimin e strukturës organizative, angazhimin e stafit shtesë dhe investime në zhvillimin profesional, veçanërisht në fushat që lidhen me monitorimin e biodiversitetit dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Ndryshe nga IKMN, Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, vlerëson se stafi ekzistues posedon profilet dhe kompetencat profesionale të nevojshme për realizimin e përgjegjësiwe institucionale, duke e vlerësuar nivelin e përgatitjes profesionale me 5 nga 5. Megjithatë, drejtoria thekson se numri aktual i punonjësve mbetet i pamjaftueshëm për shkak të ngarkesës së lartë me detyra dhe përgjegjësi shtesë. Kjo tregon se sfida kryesore nuk lidhet me cilësinë profesionale të stafit, por me kapacitetin e kufizuar njerëzor për përmbushjen e mandatit institucional.

Situatë të ngjashme paraqet edhe Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili vlerëson se shumica e inspektorëve posedojnë kualifikimet dhe kompetencat profesionale të nevojshme, ndërsa niveli i përgatitjes së tyre është vlerësuar me 4 nga 5. Megjithatë, departamenti evidenton nevojën për shtimin e numrit të inspektorëve, me qëllim përballimin e ngarkesës në rritje të punës dhe zgjerimit të kompetencave inspektuese. Sipas përgjigjeve të institucionit, për këtë qëllim

është duke u zhvilluar edhe baza ligjore që do të mundësojë rritjen e numrit të inspektorëve.

Institucioni	Numri i stafit	Profillet profesionale	Vlerësimi i përgatitjes profesionale	Nevoja kryesore e identifikuar
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN)	I pamjaftueshëm	Pjesërisht të përshtatshme	2/5	Plotësimi i strukturës organizative, angazhimi i stafit shtesë dhe ngritja e kapaciteteve profesionale
Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit (AMMK)	I pamjaftueshëm	Të përshtatshme	5/5	Rritja e numrit të punonjësve për shkak të ngarkesës së lartë të punës
Departamenti për Inspektim të Mjedisit	I pamjaftueshëm	Të përshtatshme	4/5	Rritja e numrit të inspektorëve dhe forcimi i kapaciteteve inspektuese

Tabela 1. Analiza krahasuese e kapaciteteve njerëzore të institucioneve të përfshira në hulumtim (Burimi: Bazuar në pyetësorët e institucioneve pjesëmarrëse (2025).)

Tabela 1 paraqet në mënyrë të përmblëdhur vlerësimin e institucioneve lidhur me kapacitetet e tyre njerëzore dhe profesionale. Siç evidentohet, të tri institucionet konsiderojnë se numri aktual i punonjësve nuk është i mjaftueshëm për realizimin efektiv të kompetencave të tyre, megjithëse niveli i përgatitjes profesionale ndryshon ndërmjet tyre. Ndërsa Drejtorati për Vlerësimin e

Gjendjes së Mjedisit dhe Departamenti për Inspektim vlerësojnë pozitivisht kompetencat profesionale të stafit ekzistues, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës identifikon nevojën si për shtimin e personelit, ashtu edhe për përmirësimin e profileve profesionale. Këto rezultate tregojnë se forcimi i kapaciteteve njerëzore mbetet një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Analiza krahasuese tregon se, megjithëse institucionet kanë mandate dhe përgjegjësi të ndryshme, ato përballen me një sfidë të përbashkët që lidhet me pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore. Ndërsa Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit dhe Departamenti për Inspektim të Mjedisit vlerësojnë pozitivisht nivelin profesional të stafit ekzistues, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës identifikon nevojën jo vetëm për rritjen e numrit të punonjësve, por edhe për përmirësimin e profileve profesionale dhe ngritjen e kapaciteteve teknike. Këto gjetje tregojnë se forcimi i kapaciteteve njerëzore mbetet një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Për të paraqitur në mënyrë të përmbledhur rolet institucionale në sistemin kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor, Tabela 2 sintetizon funksionet kryesore të institucioneve të përfshira në këtë hulumtim, si dhe të institucioneve që ushtrojnë kompetenca të rëndësishme në monitorimin e komponentëve të mjedisit. Kjo paraqitje mundëson një krahasim të qartë të mandateve institucionale në aspektin e monitorimit, raportimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Institucioni	Mandati kryesor	Monitorim	Raportim	Mbikëqyrje
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)	Koordinimi i monitorimit dhe raportimit mjedisor	✓	✓	✗
Drejtatori për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit	Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së mjedisit	✓	✓	✗
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN)	Monitorimi i biodiversitetit, habitateve dhe zonave të mbrojtura	✓	✓	✗
Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK)	Monitorimi i cilësisë së ajrit, ujërave dhe parametrave hidrometeorologjikë	✓	✓	✗
Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor	Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit mjedisor	✗	Pjesërisht	✓

Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, *Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024; Mjedi i Evropës 2025 - Profili i Kosovës*.

4.2 Korniza ligjore

Korniza ligjore përbën bazën mbi të cilën mbështetet funksionimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në Republikën e Kosovës. Përmes pyetësorëve është analizuar perceptimi i institucioneve lidhur me nivelin e konsolidimit të legjislacionit, harmonizimin me acquis të Bashkimit Evropian, njohuritë profesionale të stafit dhe zhvillimin e akteve nënligjore. Rezultatet tregojnë se, megjithëse legjislacioni mjedisor konsiderohet i zhvilluar në masë të konsiderueshme, institucionet eidentojnë sfida që lidhen me zbatimin

praktik të dispozitave ligjore, përditësimin e legjislacionit dhe plotësimin e akteve nënligjore. *(Pyetësorët e IKMN, Drejtoratit për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit dhe Departamentit për Inspektim të Mjedisit, 2025).*

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) e vlerëson kornizën ligjore si pjesërisht të konsoliduar, duke theksuar se një nga kufizimet kryesore lidhet me faktin se Ligji për Mbrojtjen e Natyrës ndodhet ende në proces të ridraftimit. Për këtë arsye, një pjesë e akteve nënligjore nuk kanë mundur të hartohen ose të përditësohen deri në miratimin e ligjit të ri. Instituti vlerëson gjithashtu se harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian është realizuar vetëm pjesërisht, çka tregon se zhvillimi i legjislacionit sekondar mbetet i kushtëzuar nga përfundimi i reformës ligjore në këtë sektor.

Ndryshe nga kjo qasje, Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, konsideron se baza ligjore është në masë të madhe e konsoliduar dhe se harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian është realizuar në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, drejtoria identifikon si sfidë kryesore jo legjislacionin në vetvete, por kapacitetet administrative dhe institucionale për zbatimin e tij. Sipas përgjigjeve të institucionit, mungesa e personelit të mjaftueshëm ndikon drejtpërdrejt në zbatimin, monitorimin dhe përditësimin efektiv të legjislacionit mjedisor.

Edhe Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor vlerëson se korniza ligjore është pjesërisht e konsoliduar. Sipas departamentit, mangësitë lidhen kryesisht me procedurat për monitorimin dhe vlerësimin e dëmeve mjedisore, si dhe me administrimin e disa proceseve specifike, përfshirë procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronave ujore. Po ashtu, institucioni konsideron se harmonizimi me legjislacionin

evropian ende nuk është përfunduar plotësisht dhe se nevojiten përmirësime të mëtejshme në disa segmente procedurale.

Analiza e pyetësorëve evidenton gjithashtu një nivel të ndryshëm të njohurive profesionale të stafit lidhur me legjislacionin mjedisor. Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit e ka vlerësuar nivelin e njohjes së kornizës ligjore me 5 nga 5, ndërsa Departamenti për Inspektim të Mjedisit e konsideron atë në nivel të mirë. Në anën tjetër, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës vlerëson se njohuritë profesionale të stafit janë vetëm pjesërisht të mjaftueshme, një konstatim që përputhet edhe me vlerësimin më të ulët të kapaciteteve njerëzore të paraqitur në nënkapitullin paraprak.

Sa i përket zhvillimit të akteve nënligjore, rezultatet tregojnë dallime të dukshme ndërmjet institucioneve. IKMN thekson se një pjesë e akteve nënligjore nuk janë hartuar për shkak të pritjes së miratimit të Ligjit të ri për Mbrojtjen e Natyrës. Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit njofton se shumica e akteve nënligjore janë miratuar dhe janë në fuqi, ndërsa ato që nuk janë finalizuar për arsye teknike janë bartur në Programin Legjislativ për vitin 2026. Nga ana tjetër, Departamenti për Inspektim të Mjedisit sqaron se nuk harton akte nënligjore, pasi funksioni i tij është zbatimi dhe mbikëqyrja e legjislacionit ekzistues.

Në përgjithësi, analiza tregon se perceptimi i institucioneve mbi nivelin e zhvillimit të kornizës ligjore ndryshon në varësi të mandatit dhe përgjegjësi që ato ushtrojnë. Megjithatë, të gjitha institucionet pajtohen se zhvillimi i mëtejshëm i sistemit kërkon përfundimin e reformave ligjore në proces, plotësimin e akteve nënligjore, harmonizimin e vazhdueshëm me acquis të Bashkimit Evropian dhe, mbi të gjitha, forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të legjislacionit mjedisor. Këto elemente përbëjnë parakusht

për funksionimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

4.3 Dokumentet e planifikimit, programet, projektet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit

Dokumentet strategjike dhe programore përbëjnë bazën e planifikimit të politikave mjedisore dhe orientojnë veprimet institucionale për mbrojtjen, ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit. Përmes pyetësorëve është analizuar roli i institucioneve në hartimin e strategjive, planeve, programeve, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit, si dhe niveli i përfshirjes së tyre në zbatimin e këtyre dokumenteve. Rezultatet tregojnë se përgjegjësitë në këtë fushë janë të ndara sipas mandateve institucionale, duke reflektuar funksione të ndryshme në procesin e planifikimit, mbështetjes profesionale dhe zbatimit të politikave mjedisore.

Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, rezulton të ketë rolin më të gjerë në procesin e planifikimit mjedisor. Sipas përgjigjeve të institucionit, drejtoria merr pjesë në hartimin, monitorimin dhe koordinimin e dokumenteve strategjike të nivelit qendror, ndër të cilat Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit, Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035, Plani i Veprimit 2024–2026, si dhe Programi për Parandalimin e Mbeturinave dhe Programi për Plastikë Njëpërdorimëshe. Një pjesë e këtyre dokumenteve ndodhen ende në fazën e draftimit ose të finalizimit, çka tregon se procesi i planifikimit strategjik vazhdon të zhvillohet në përputhje me prioritetet e politikave mjedisore dhe procesin e harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Drejtoria vlerëson gjithashtu se dokumentet strategjike janë të harmonizuara me politikat sektoriale dhe hartohen në përputhje me kompetencat institucionale. Megjithatë, fakti që disa dokumente programore ende nuk janë miratuar tregon se procesi i planifikimit mbetet dinamik dhe i varur nga zhvillimi i mëtejshëm i legjislacionit, koordinimi ndërinstitutional dhe prioritetet e politikave publike.

Në dallim nga Drejtorati, Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ushtron kompetenca në hartimin e strategjive apo dokumenteve të planifikimit. Sipas përgjigjeve të institucionit, mandati i departamentit është i orientuar në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe jo në zhvillimin e politikave apo dokumenteve strategjike. Kontributi i tij në mbrojtjen e mjedisit realizohet përmes aktiviteteve inspektuese, duke përfshirë nxjerrjen e vendimeve për ndërprerjen e aktiviteteve që bien ndesh me legjislacionin, shqiptimin e masave administrative dhe ndjekjen e zbatimit të dispozitave ligjore. Ky rol e pozicionon departamentin si mekanizëm zbatues dhe mbikëqyrës të politikave mjedisore, më shumë sesa si institucion planifikues.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) ushtron një rol të specializuar në procesin e planifikimit, të kufizuar në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Kontributi i institutit fokusohet në ofrimin e ekspertizës profesionale, përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe pjesëmarrjen në hartimin e dokumenteve që lidhen me zonat e mbrojtura, habitatet natyrore dhe ruajtjen e biodiversitetit. Për shkak të mandatit të tij specifik, instituti nuk është përgjegjës për hartimin e strategjive të përgjithshme kombëtare të mjedisit, por ofron mbështetje teknike dhe shkencore në fushat që mbulon.

Analiza krahasuese tregon se planifikimi mjedisor në administratën qendrore është i organizuar sipas kompetencave funksionale të institucioneve. Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit udhëheq proceset e planifikimit dhe koordinimit strategjik, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ofron mbështetje profesionale dhe shkencore në fushën e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura, ndërsa Departamenti për Inspektim të Mjedisit siguron zbatimin praktik të politikave dhe legjislacionit përmes mbikëqyrjes inspektuese. Kjo ndarje e përgjegjësisë krijon një sistem komplementar, në të cilin planifikimi strategjik, ekspertiza teknike dhe zbatimi në terren plotësojnë njëri-tjetrin. Megjithatë, funksionimi efektiv i këtij sistemi kërkon koordinim të vazhdueshëm ndërinstitutional, përditësim të dokumenteve strategjike dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për zbatimin e tyre.

4.4 Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Mbikëqyrja inspektive përbën një aspekt thelbësor të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor, pasi siguron kontrollin e zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe identifikimin e shkeljeve që mund të ndikojnë në cilësinë e mjedisit. Përmes aktiviteteve inspektuese verifikohet respektimi i kërkesave ligjore nga operatorët ekonomikë dhe institucionet publike, ndërsa rezultatet e inspektimeve shërbejnë si burim i rëndësishëm informacioni për vlerësimin e nivelit të zbatimit të legjislacionit dhe efektivitetit të masave për mbrojtjen e mjedisit.

Analiza e pyetësorëve tregon se Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor është institucioni qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor. Veprimtaria e tij përfshin kryerjen e inspektimeve, evidentimin e shkeljeve, shqiptimin e masave administrative dhe mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve

inspektuese. Në këtë mënyrë, departamenti luan një rol kyç në parandalimin e dëmtimeve mjedisore dhe në forcimin e zbatimit të legjislacionit në praktikë.

Sipas përgjigjeve të institucionit, aktiviteti inspektues realizohet në bashkëpunim me institucione të tjera kompetente, në varësi të natyrës së rasteve të trajtuara. Ky bashkëpunim është i domosdoshëm, pasi monitorimi mjedisor dhe mbikëqyrja nspective përfshijnë institucione me mandate të ndryshme, ndërsa informacioni i prodhuar nga sistemet e monitorimit përdoret për planifikimin e kontrolleve inspektuese dhe përcaktimin e prioritetëve të mbikëqyrjes.

Në dallim nga departamenti inspektues, Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e nspective Kosovës, nuk ushtron kompetenca inspektuese, por ka përgjegjësi qendrore në monitorimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit. Aktiviteti i tij përfshin mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave mjedisore, administrimin e informacionit mjedisor dhe përgatitjen e raporteve periodike mbi gjendjen e mjedisit. Informacioni i prodhuar nga drejtoria shërben si bazë për hartimin e politikave publike dhe njëkohësisht mbështet planifikimin e aktiviteteve inspektuese në nivel qendror.

Edhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) nuk ushtron funksione inspektuese, por kontribuon në nspecti kombëtar të raportimit përmes monitorimit të biodiversitetit, habitateve natyrore dhe zonave të mbrojtura. Të dhënat dhe vlerësimet profesionale të institutit përdoren në hartimin e raporteve dhe dokumenteve strategjike për mbrojtjen e natyrës, duke siguruar mbështetje shkencore dhe teknike për procesin e vendimmarrjes.

Analiza krahasuese evidenton një ndarje të qartë funksionale ndërmjet institucioneve. Departamenti për Inspektim të Mjedisit është përgjegjës për

kontrollin dhe zbatimin e legjislacionit, Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit për monitorimin, administrimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, ndërsa Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës për monitorimin e biodiversitetit dhe ofrimin e ekspertizës profesionale në fushën e mbrojtjes së natyrës. Kjo ndarje e përgjegjësi krijon një spec komplementar, ku monitorimi, raportimi dhe mbikëqyrja nspective mbështesin njëra-tjetrën. Megjithatë, efektiviteti i këtij sistemi varet nga koordinimi ndërinstitutional, shkëmbimi i rregullt i informacionit dhe përdorimi i të dhënave të monitorimit në planifikimin e aktiviteteve inspektuese dhe hartimin e politikave mjedisore.

4.5 Sistemet e monitorimit mjedisor

Sistemet e monitorimit mjedisor përbëjnë bazën për vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm për hartimin e politikave publike, planifikimin e masave mbrojtëse dhe raportimin institucional. Përmes monitorimit sistematik të komponentëve të ndryshëm të mjedisit mundësohet identifikimi i ndryshimeve në cilësinë e mjedisit, evidentimi i presioneve antropogjene dhe natyrore, si dhe vlerësimi i efektivitetit të masave të ndërmarra për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Analiza e pyetësorëve tregon se institucionet e përfshira në këtë hulumtim ushtrojnë funksione të ndryshme monitoruese, të përcaktuara sipas mandateve dhe kompetencave të tyre ligjore.

Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ushtron rolin qendror në sistemin kombëtar të monitorimit mjedisor. Sipas përgjigjeve të institucionit, drejtorja koordinon mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave për komponentët kryesorë të mjedisit dhe kontribuon në përgatitjen e raporteve kombëtare mbi gjendjen e mjedisit. Veprimtaria e saj është e orientuar drejt monitorimit

sistematik të indikatorëve mjedisorë, administrimit të informacionit mjedisor dhe sigurimit të të dhënave që shërbejnë si bazë për raportimin institucional dhe hartimin e politikave publike.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) zhvillon monitorim të specializuar në fushën e biodiversitetit, habitateve natyrore dhe zonave të mbrojtura. Sipas përgjigjeve të institucionit, aktivitetet monitoruese janë të fokusuara në vlerësimin e gjendjes së ekosistemeve, ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe monitorimin e specieve dhe habitateve me rëndësi të veçantë. Monitorimi i parametrave të tjerë mjedisorë, si cilësia e ajrit, ujërave ose tokës, nuk bën pjesë në mandatin e institutit. Kjo ndarje e kompetencave siguron specializim institucional dhe shmang mbivendosjen e përgjegjësi ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Në dallim nga këto institucione, Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor nuk zhvillon monitorim teknik të parametrave mjedisorë, por mbikëqyr respektimin e legjislacionit përmes aktiviteteve inspektuese. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij evidentohen forma të ndryshme të degradimit të mjedisit, si hedhja e mbeturinave në hapësira publike, krijimi i deponive ilegale, shfrytëzimi i materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve, prerjet ilegale të pyjeve dhe ndërtimet pa leje. Megjithëse këto aktivitete nuk përfaqësojnë monitorim të drejtpërdrejtë të parametrave mjedisorë, ato ofrojnë informacion të vlefshëm mbi presionet antropogjene dhe problematikat që ndikojnë në gjendjen e mjedisit, duke plotësuar informacionin e prodhuar nga sistemet teknike të monitorimit.

Analiza tregon se monitorimi mjedisor në administratën qendrore është organizuar sipas një modeli funksional të decentralizuar, ku secili institucion

monitoron komponentët ose proceset që i janë përcaktuar me mandat ligjor. Kjo ndarje e kompetencave mundëson specializim profesional dhe përdorim më efikas të burimeve institucionale, por njëkohësisht rrit nevojën për koordinim ndërinstitutional, shkëmbim të rregullt të të dhënave dhe harmonizim të metodologjive të monitorimit. Integrimi i informacionit të prodhuar nga institucionet është parakusht për përgatitjen e raporteve kombëtare gjithëpërfshirëse mbi gjendjen e mjedisit dhe për mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

Në përgjithësi, gjetjet tregojnë se sistemi ekzistues i monitorimit mbështetet në një ndarje të qartë funksionale të përgjegjësive ndërmjet institucioneve, ndërsa sfidat kryesore lidhen me forcimin e koordinimit institucional, standardizimin e metodologjive të monitorimit, shkëmbimin sistematik të të dhënave dhe zhvillimin e sistemeve të integruara të informacionit mjedisor. Përmirësimi i këtyre elementeve do të kontribuonte në rritjen e cilësisë dhe krahasueshmërisë së të dhënave, përgatitjen e raporteve më të plota dhe më të besueshme, si dhe në forcimin e bazës shkencore për hartimin dhe zbatimin e politikave mjedisore në Republikën e Kosovës.

Monitorimi mjedisor në Republikën e Kosovës realizohet përmes një sistemi të organizuar sipas komponentëve kryesorë të mjedisit. Secili komponent monitorohet nga institucione përgjegjëse sipas mandatit të tyre ligjor, duke përdorur metoda dhe sisteme specifike monitorimi. Për një paraqitje të përmbledhur të këtij sistemi, në vijim paraqitet TABELA 3.

Komponenti mjedisor	Institucioni përgjegjës	Lloji i monitorimit	Produkti kryesor
Cilësia e ajrit	AMMK / IHMK	Monitorim automatik përmes rrjetit të stacioneve monitoruese	Raporti Vjetor për Gjendjen e Ajrit
Ujërat sipërfaqësore	IHKM	Monitorim fizik, kimik dhe biologjik	Raportet për gjendjen e ujërave
Ujërat nëntokësore	IHKM	Monitorim i nivelit dhe cilësisë së ujërave	Raporte periodike
Toka	MMPHI dhe institucionet kompetente	Monitorim i cilësisë dhe degradimit të tokës	Tregues të gjendjes së tokës
Biodiversiteti	IKMN	Monitorim i habitateve, specieve dhe zonave të mbrojtura	Raporte për biodiversitetin
Mbeturinat	AMMK	Monitorim i gjenerimit, trajtimit dhe deponimit	Raporti për Menaxhimin e Mbeturinave
Gazrat serrë	AMMK	Inventari Kombëtar i Gazrave Serrë	Raportim sipas metodologjisë IPCC

Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, *Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024*.

4.6 Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore

Menaxhimi i të dhënave mjedisore përbën një vidence thelbësor të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor, pasi mundëson mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe mbështetjen e procesit të vendimmarrjes.

Cilësia, besueshmëria dhe qasshmëria e të dhënave ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e raporteve mjedisore, planifikimin e politikave publike dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit. Për këtë arsye, zhvillimi i sistemeve efikase të menaxhimit të të dhënave përfaqëson një nga elementet kyçe të administrimit modern mjedisor.

Analiza e pyetësorëve tregon se institucionet përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të ndryshëm për administrimin e të dhënave mjedisore, në përputhje me mandatet dhe kompetencat e tyre. Megjithatë, niveli i zhvillimit të këtyre sistemeve nuk është i njëjtë në të gjitha institucionet, ndërsa në disa raste evidentohen kufizime që lidhen me kapacitetet teknike, nivelin e digjitalizimit dhe burimet njerëzore të disponueshme.

Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e videnceë Kosovës, paraqet nivelin më të avancuar të administrimit të informacionit mjedisor. Si institucion përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit, drejtoria administron informacion nga komponentë të ndryshëm mjedisorë dhe e përdor atë për përgatitjen e raporteve kombëtare, analizave tematike dhe raportimit ndaj institucioneve përgjegjëse. Për këtë arsye, ajo përfaqëson një qendrore të sistemit kombëtar të informacionit mjedisor dhe luan rol kyç në integrimin e të dhënave të prodhuara nga institucionet e tjera.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) administron informacion të specializuar që lidhet me biodiversitetin, habitatet natyrore, viden e mbrojtura dhe zonat e mbrojtura. Për shkak të mandatit të tij vidence, baza e të dhënave e institutit është e orientuar drejt komponentëve të natyrës dhe nuk mbulon të gjithë treguesit mjedisorë. Megjithatë, informacioni i prodhuar nga vidence përbën një burim të rëndësishëm për raportimin kombëtar dhe ndërkombëtar

në fushën e biodiversitetit dhe mbështet procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes për ruajtjen e trashëgimisë natyrore.

Në rastin e Departamentit për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor, analiza tregon se administrimi i informacionit është i orientuar kryesisht drejt mbështetjes së aktiviteteve inspektuese. Institucioni disponon baza të të dhënave për operatorët sipas fushave përkatëse, të cilat përdoren gjatë planifikimit dhe realizimit të inspektimeve. Megjithatë, departamenti evidenton se nuk disponon ende kapacitete të plota për krijimin, grumbullimin dhe administrimin e informacionit mjedisor. Sipas përgjigjeve të institucionit, sfidat kryesore lidhen me mungesën e inspektorëve, nevojën për digjitalizimin e proceseve të punës dhe zhvillimin e sistemeve më efikase të administrimit të informacionit.

Një gjetje e përbashkët e analizës është se administrimi i të dhënave mjedisore realizohet në mënyrë sektoriale, ku secili institucion menaxhon informacionin që lidhet me kompetencat e veta ligjore. Edhe pse kjo ndarje është në përputhje me strukturën institucionale, ajo krijon nevojën për mekanizma më të avancuar të shkëmbimit dhe integritit të informacionit ndërmjet institucioneve. Mungesa e interoperabilitetit të plotë ndërmjet sistemeve ekzistuese kufizon përdorimin efikas të informacionit, rrit rrezikun e fragmentimit të të dhënave dhe mund të ndikojë në cilësinë e raportimit kombëtar mbi gjendjen e mjedisit.

Në përgjithësi, analiza tregon se institucionet kanë krijuar bazat për administrimin e informacionit mjedisor, por niveli i zhvillimit të sistemeve mbetet i ndryshëm ndërmjet tyre. Forcimi i kapaciteteve teknike, digjitalizimi i proceseve të punës, zhvillimi i databazave të integruara, rritja e interoperabilitetit dhe standardizimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve paraqiten si prioritetet kryesore për përmirësimin e sistemit

kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor. Këto masa do të kontribuonin në rritjen e cilësisë, besueshmërisë dhe përdorshmërisë së informacionit mjedisor, duke forcuar bazën për vendimmarrje të bazuar në vidence dhe përmbushjen e standardeve të Bashkimit Evropian.

4.7 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitutional përbëjnë elemente thelbësore për funksionimin efektiv të sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor. Duke qenë se përgjegjësitë për monitorimin e komponentëve të ndryshëm të mjedisit janë të shpërndara ndërmjet institucioneve të ndryshme, shkëmbimi i rregullt i informacionit dhe koordinimi i aktiviteteve janë parakusht për krijimin e një sistemi të integruar dhe funksional të monitorimit dhe raportimit. Analiza e pyetësorëve tregon se të gjitha institucionet pjesëmarrëse bashkëpunojnë me institucione të tjera publike në ushtrimin e kompetencave të tyre, megjithëse forma dhe intensiteti i këtij bashkëpunimi ndryshojnë në varësi të mandateve institucionale.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) zhvillon bashkëpunim me institucione të nivelit qendror dhe lokal në çështjet që lidhen me mbrojtjen e natyrës, biodiversitetin, menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe ofrimin e opinioneve profesionale. Për shkak të mandatit të tij shkencor dhe teknik, bashkëpunimi është i orientuar kryesisht drejt shkëmbimit të ekspertizës, koordinimit profesional dhe mbështetjes së proceseve të vendimmarrjes në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, ka rol koordinues në procesin e monitorimit dhe raportimit mjedisor. Sipas përgjigjeve të institucionit, drejtoria bashkëpunon me institucionet që prodhojnë të dhëna mjedisore për sigurimin,

verifikimin dhe përpunimin e informacionit që përdoret në raportet kombëtare mbi gjendjen e mjedisit. Përmes këtij funksioni ajo vepron si nyja kryesore e koordinimit të informacionit mjedisor, duke lidhur institucionet që gjenerojnë të dhëna me ato që i përdorin në hartimin e politikave dhe dokumenteve strategjike.

Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor bashkëpunon rregullisht me institucionet qendrore dhe komunale gjatë ushtrimit të kompetencave inspektuese. Përgjigjet e pyetësorit tregojnë se departamenti ka organizuar trajnime për inspektorët komunalë në të shtatë rajonet e Kosovës, të fokusuara në zbatimin e Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, ndarjen e kompetencave ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, si dhe procedurat e mbikëqyrjes inspektuese. Krahas kësaj, departamenti ofron mbështetje profesionale për komunat në trajtimin e rasteve specifike mjedisore dhe interpretimin e dispozitave ligjore. Këto aktivitete tregojnë se koordinimi ndërinstitutional nuk kufizohet vetëm në shkëmbimin e informacionit, por përfshin edhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve të nivelit lokal.

Analiza krahasuese tregon se koordinimi ndërinstitutional realizohet kryesisht mbi bazën e kompetencave ligjore të secilit institucion dhe funksionon në mënyrë operative. Megjithatë, institucionet evidentojnë nevojën për forcimin e mekanizmave formalë të koordinimit, zhvillimin e sistemeve të interoperabilitetit, përmirësimin e shkëmbimit elektronik të informacionit dhe krijimin e platformave të përbashkëta për administrimin e të dhënave mjedisore. Përmirësimi i këtyre mekanizmave do të kontribuonte në shmangien e mbivendosjes së aktiviteteve, rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e cilësisë së monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Pjesëmarrja publike përfaqëson një komponent të rëndësishëm të qeverisjes mjedisore dhe lidhet ngushtë me transparencën institucionale, qasjen në informacion dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Analiza tregon se institucionet e përfshira e konsiderojnë informimin e publikut pjesë të mandatit të tyre, megjithëse format e angazhimit ndryshojnë sipas funksioneve që ushtrojnë. Institucionet me rol teknik dhe shkencor fokusohen kryesisht në publikimin e raporteve, të dhënave dhe dokumenteve mjedisore, ndërsa strukturat inspektuese kanë ndërveprim më të drejtpërdrejtë me qytetarët përmes trajtimit të ankesave, denoncimeve dhe rasteve të shkeljeve mjedisore. Kjo qasje është në përputhje me parimet e transparencës dhe pjesëmarrjes publike të parashikuara në Konventën e Aarhusit, e cila promovon qasjen në informacion mjedisor, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore. Megjithatë, rezultatet e analizës tregojnë se ekziston ende hapësirë për zhvillimin e mekanizmave më të strukturuar të komunikimit dhe konsultimit publik, me qëllim rritjen e besimit të qytetarëve dhe forcimin e qeverisjes mjedisore.

4.8 Licencimi dhe lejet mjedisore

Licencimi dhe pajisja me leje mjedisore përbëjnë instrumente të rëndësishme për parandalimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative në mjedis. Përmes këtyre mekanizmave sigurohet që aktivitetet ekonomike dhe zhvillimore të realizohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit. Analiza e pyetësorëve tregon se, ndonëse institucionet e përfshira nuk ushtrojnë të gjitha të njëjtin rol në procesin e licencimit, ato kontribuojnë në faza të ndryshme të tij, duke ofruar të dhëna, ekspertizë profesionale ose duke mbikëqyrur zbatimin e kushteve të përcaktuara në lejet mjedisore.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit, në kuadër të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, nuk është institucioni kompetent për lëshimin e lejeve apo licencave mjedisore, por ushtron një rol mbështetës në procesin e vendimmarrjes. Përgjigjet e pyetësorit tregojnë se drejtoria siguron të dhëna mjedisore, analiza teknike dhe informacion mbi gjendjen e mjedisit, të cilat përdoren gjatë procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe proceseve të tjera që lidhen me pajisjen me leje mjedisore. Në këtë mënyrë, sistemi i monitorimit ofron bazën faktike mbi të cilën mbështeten vendimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) gjithashtu nuk ushtron kompetenca për lëshimin e lejeve mjedisore, por ofron ekspertizë profesionale në rastet kur aktivitetet e planifikuara zhvillohen në zona të mbrojtura ose mund të kenë ndikim në biodiversitet, habitatet natyrore dhe vlerat e mbrojtura të natyrës. Kontributi i institutit konsiston në përgatitjen e opinionëve profesionale dhe rekomandimeve teknike, të cilat mbështesin institucionet kompetente gjatë procesit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

Roli më i drejtpërdrejtë në këtë fushë i takon Departamentit për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili mbikëqyr zbatimin e kushteve të përcaktuara në lejet dhe autorizimet mjedisore gjatë ushtrimit të veprimtarive të operatorëve ekonomikë. Sipas përgjigjeve të institucionit, aktivitetet inspektuese përfshijnë kontrollin e respektimit të detyrimeve ligjore dhe kushteve të përcaktuara në lejet mjedisore, ndërsa në rastet kur evidentohen shkelje ndërmerren masa administrative dhe ndëshkuese në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni vlerëson gjithashtu se rastet e mosrespektimit të kushteve janë më të shpeshta tek aktivitetet ilegale ose subjektet që operojnë jashtë kuadrit ligjor, ndërsa

subjektet e pajisura me autorizime të rregullta, në përgjithësi, respektojnë detyrimet e përcaktuara.

Analiza tregon se procesi i licencimit nuk përfaqëson vetëm një procedurë administrative, por është pjesë e një sistemi më të gjerë të monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve me ndikim në mjedis. Cilësia e të dhënave mjedisore, ekspertiza profesionale dhe kontrolli i vazhdueshëm i zbatimit të kushteve të përcaktuara në leje ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitetin e këtij sistemi dhe në parandalimin e dëmtimeve mjedisore.

Në përgjithësi, rezultatet e analizës tregojnë se institucionet e përfshira ushtrojnë role komplementare në procesin e licencimit dhe mbikëqyrjes së lejeve mjedisore. Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit siguron bazën teknike dhe informacionin mjedisor, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ofron ekspertizë profesionale në fushën e mbrojtjes së natyrës, ndërsa Departamenti për Inspektim të Mjedisit garanton kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në lejet mjedisore. Kjo ndarje e përgjegjësisë krijon një mekanizëm të integruar ku monitorimi, vlerësimi teknik dhe mbikëqyrja inspektuese plotësojnë njëra-tjetrën. Megjithatë, funksionimi efektiv i këtij sistemi kërkon koordinim të vazhdueshëm ndërinstitutional, shkëmbim të rregullt të informacionit dhe forcim të kapaciteteve administrative për të siguruar zbatim të qëndrueshëm të legjislacionit mjedisor.

4.9 Gjetjet kryesore të analizës

Analiza e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve të plotësuar nga institucionet qendrore përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mjedisor ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi funksionimin e sistemit aktual të monitorimit mjedisor në Republikën e Kosovës. Rezultatet tregojnë se, megjithëse institucionet ushtrojnë mandate dhe kompetenca të ndryshme, ato janë pjesë e një sistemi të ndërlidhur, në të cilin monitorimi, raportimi, ekspertiza profesionale dhe mbikëqyrja inspektive plotësojnë njëra-tjetrën. Në të njëjtën kohë, analiza evidenton një sërë sfidash strukturore dhe operacionale që ndikojnë në efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.

Një nga gjetjet kryesore lidhet me ndarjen funksionale të përgjegjësisë ndërmjet institucioneve. Drejtorati për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka rol qendror në monitorimin dhe raportimin e gjendjes së mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës është përgjegjës për monitorimin e biodiversitetit, habitateve dhe zonave të mbrojtura, ndërsa Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyr zbatimin e legjislacionit mjedisor. Kjo ndarje e kompetencave shmang mbivendosjen e funksioneve dhe mundëson specializimin institucional, duke krijuar bazën për një sistem të organizuar të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Një sfidë e përbashkët e evidentuar nga të gjitha institucionet është pamjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore. Pavarësisht nivelit të ndryshëm të përgatitjes profesionale të stafit, të gjitha institucionet theksojnë nevojën për shtimin e personelit dhe forcimin e kapaciteteve profesionale, për shkak të rritjes së vazhdueshme të përgjegjësisë dhe kompleksitetit të proceseve të monitorimit, raportimit dhe mbikëqyrjes mjedisore. Në disa raste është

identifikuar edhe nevoja për profile më të specializuara dhe për programe të vazhdueshme të zhvillimit profesional.

Në aspektin ligjor, rezultatet tregojnë se ekziston një bazë ligjore funksionale për monitorimin dhe raportimin mjedisor, por procesi i konsolidimit të saj ende nuk është përfunduar. Institucionet evidentojnë nevojën për përfundimin e reformave ligjore në zhvillim, hartimin e akteve nënligjore të munguara dhe harmonizimin e mëtejshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian. Këto elemente konsiderohen të domosdoshme për forcimin e sigurisë juridike dhe përmirësimin e zbatimit praktik të legjislacionit mjedisor.

Një tjetër gjetje me rëndësi lidhet me administrimin e informacionit mjedisor. Edhe pse institucionet kanë krijuar mekanizma për menaxhimin e të dhënave në përputhje me kompetencat e tyre, niveli i digjitalizimit, interoperabilitetit dhe integritetit të sistemeve mbetet i kufizuar. Fragmentimi i informacionit ndërmjet institucioneve kufizon shkëmbimin efikas të të dhënave dhe vështirëson krijimin e një sistemi të unifikuar të informacionit mjedisor në nivel kombëtar. Për këtë arsye, zhvillimi i databazave të integruara dhe standardizimi i proceseve të administrimit të informacionit paraqiten si prioritet për avancimin e sistemit.

Rezultatet tregojnë se bashkëpunimi ndërinstitutional zhvillohet në bazë të kompetencave ligjore të secilit institucion dhe realizohet përmes shkëmbimit të informacionit, koordinimit të aktiviteteve, mbështetjes profesionale dhe bashkërendimit të veprimeve inspektuese. Megjithatë, analiza eidenton nevojën për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, përmirësimin e mekanizmave formalë të koordinimit, zhvillimin e platformave të përbashkëta për shkëmbimin e informacionit, si dhe organizimin më të rregullt të trajnimeve dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të institucioneve lokale. Këto masa do të kontribuonin në rritjen e efikasitetit

institucional dhe përmirësimin e cilësisë së sistemit kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor.

Në tërësi, analiza tregon se sistemi i monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore mbështetet në një strukturë institucionale funksionale dhe në një ndarje të qartë të përgjegjësive ndërmjet institucioneve. Megjithatë, zhvillimi i mëtejshëm i këtij sistemi kërkon forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike, përsheptimin e digjitalizimit, përmirësimin e interoperabilitetit të sistemeve të informacionit, konsolidimin e kornizës ligjore dhe avancimin e koordinimit ndërinstitutional. Adresimi i këtyre sfidave do të kontribuonte në rritjen e cilësisë së monitorimit dhe raportimit mjedisor, në mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë dhe në përmbushjen më efektive të detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Gjetjet e paraqitura në këtë kapitull shërbejnë si bazë për formulimin e rekomandimeve të paraqitura në kapitullin vijues.

5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

5.1 Përfundimet

Analiza e realizuar në kuadër të këtij raporti tregon se sistemi i monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore të Republikës së Kosovës mbështetet në një strukturë institucionale të konsoliduar, ku kompetencat për monitorimin, raportimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor janë të ndara ndërmjet institucioneve sipas mandateve të tyre. Kjo ndarje funksionale krijon bazën për një sistem të specializuar të monitorimit mjedisor dhe shmang mbivendosjen e përgjegjësive institucionale. Megjithatë, analiza tregon se funksionimi efektiv i këtij sistemi varet në masë të madhe nga koordinimi ndërinstitucional dhe shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit.

Gjendja aktuale e mjedisit në Republikën e Kosovës paraqet një sfidë të vazhdueshme për institucionet përgjegjëse, shoqërinë civile dhe qytetarët në përgjithësi. Ndikimi i aktiviteteve ekonomike, urbanizimi i shpejtë, mungesa e infrastrukturës së përshtatshme për trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të ndotura, si dhe përdorimi i paqëndrueshëm i resurseve natyrore, ka sjellë pasoja serioze në komponentët kryesore të mjedisit. Rezultatet e pyetësorëve evidentojnë se institucionet kanë zhvilluar praktika të monitorimit dhe raportimit në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, mirëpo një pjesë e konsiderueshme e sfidave lidhen me kapacitetet njerëzore dhe teknike. Mungesa e personelit të mjaftueshëm është identifikuar nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse, ndërsa disa prej tyre kanë theksuar edhe nevojën për profile profesionale më të specializuara dhe për zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve përmes trajnimeve. Këto kufizime ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e monitorimit, analizimit dhe raportimit të të dhënave mjedisore.

Në aspektin e kornizës ligjore, analiza tregon se legjislacioni mjedisor ofron bazën për funksionimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit, por njëkohësisht evidentohen nevoja për përditësimin e akteve nënligjore, përfundimin e proceseve të reformimit të disa ligjeve sektoriale dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet e Bashkimit Evropian. Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore mbetet një parakusht për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit institucional.

Analiza gjithashtu tregon se menaxhimi i të dhënave mjedisore realizohet në mënyrë sektoriale, ku secili institucion administron informacionin që lidhet me fushën e vet të kompetencës. Edhe pse kjo qasje siguron specializim, mungesa e sistemeve të integruara të informacionit dhe e mekanizmave të avancuar të shkëmbimit të të dhënave kufizon potencialin për një raportim më gjithëpërfshirës dhe më efikas në nivel kombëtar. Digjitalizimi i proceseve dhe zhvillimi i platformave të përbashkëta të informacionit paraqiten si nevoja të rëndësishme për të ardhmen.

Një gjetje tjetër e rëndësishme lidhet me bashkëpunimin ndërinstitutional. Institutionet bashkëpunojnë rregullisht në shkëmbimin e informacionit, mbështetjen profesionale dhe zbatimin e kompetencave të tyre, megjithatë analiza tregon se ekziston potencial për forcimin e mekanizmave formalë të koordinimit, standardizimin e procedurave të raportimit dhe zhvillimin e një sistemi më të integruar të monitorimit mjedisor në nivel kombëtar.

Në përgjithësi, rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se sistemi i monitorimit dhe raportimit mjedisor në administratën qendrore ka krijuar bazat institucionale për përmbushjen e funksioneve të tij, por zhvillimi i mëtejshëm kërkon investime të vazhdueshme në burime njerëzore, kapacitete teknike, digjitalizim, koordinim institucional dhe harmonizim me praktikën më të mira evropiane.

Përmirësimi i këtyre elementeve do të kontribuojë në prodhimin e të dhënave më cilësore, rritjen e transparencës institucionale dhe mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në evidencë në sektorin e mjedisit.

5.2 Rekomandimet

Bazuar në analizën e realizuar dhe në gjetjet e identifikuara gjatë shqyrtimit të pyetësorëve të institucioneve qendrore, rekomandimet e mëposhtme synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit mjedisor në Republikën e Kosovës.

Forcimi i kapaciteteve institucionale - Institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mjedisor duhet të vazhdojnë forcimin e kapaciteteve të tyre institucionale përmes rritjes së numrit të stafit profesional, plotësimit të profileve deficitare dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të shërbyesve civil. Investimi në burimet njerëzore është parakusht për përmirësimin e cilësisë së monitorimit, analizimit dhe raportimit të të dhënave mjedisore.

Përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional - Duhet të forcohen mekanizmat formalë të koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për monitorimin, raportimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit mjedisor. Kjo mund të realizohet përmes krijimit të procedurave të standardizuara për shkëmbimin e të dhënave, organizimit të takimeve periodike koordinuese dhe përcaktimit të qartë të roleve dhe përgjegjësi në procesin e raportimit mjedisor.

Digjitalizimi i sistemeve të monitorimit dhe menaxhimit të të dhënave - Institucionet duhet të investojnë në zhvillimin e sistemeve moderne të informacionit mjedisor, të cilat mundësojnë mbledhjen, ruajtjen, analizimin dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet institucioneve. Zhvillimi i

databazave të integruara dhe sistemeve interoperabile do të rriste efikasitetin e monitorimit dhe do të përmirësonte cilësinë e raportimit mjedisor.

Standardizimi i metodologjive të monitorimit - Rekomandohet harmonizimi i metodologjive të monitorimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, duke përdorur indikatorë të standardizuar, procedura të unifikuara të mbledhjes së të dhënave dhe formate të përbashkëta raportimi. Kjo do të siguronte krahasueshmërinë e të dhënave dhe do të lehtësonte përgatitjen e raporteve kombëtare mbi gjendjen e mjedisit.

Përmirësimi i kornizës ligjore - Duhet të vazhdojë procesi i harmonizimit të legjislacionit mjedisor me acquis të Bashkimit Evropian, duke përfunduar hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore të mbetura, përditësimin e dispozitave që lidhen me monitorimin mjedisor dhe adresimin e mangësive procedurale të identifikuara nga institucionet përgjegjëse.

Zhvillimi i programeve të vazhdueshme të trajnimit - Institucionet duhet të organizojnë programe të rregullta trajnimi për stafin profesional dhe teknik në fushat e monitorimit mjedisor, analizës së të dhënave, përdorimit të teknologjive të reja, sistemeve të informacionit gjeografik (GIS), raportimit mjedisor dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian. Trajnimet duhet të përfshijnë edhe nivelin lokal, me qëllim unifikimin e praktikave të monitorimit në të gjithë territorin e Kosovës.

Forcimi i monitorimit të bazuar në evidence - Institucionet duhet të zhvillojnë më tej monitorimin e bazuar në indikatorë të matshëm dhe në të dhëna të verifikueshme. Vendimmarrja në sektorin e mjedisit duhet të mbështetet në analiza shkencore dhe në të dhëna të përditësuara, duke reduktuar varësinë nga vlerësimet subjektive dhe duke rritur cilësinë e politikave publike.

Rritja e transparencës dhe qasjes në të dhënat mjedisore - Rekomandohet publikimi më i rregullt i raporteve mjedisore, indikatorëve dhe databazave që nuk kufizohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave. Qasja më e lehtë në informacionin mjedisor do të kontribuonte në rritjen e transparencës institucionale, përfshirjen e publikut dhe mbështetjen e kërkimeve shkencore.

Forcimi i bashkëpunimit me institucionet akademike dhe organizatat e shoqërisë civile - Institucionet publike duhet të zgjerojnë bashkëpunimin me universitetet, institutet kërkimore dhe organizatat e shoqërisë civile për zhvillimin e metodologjive të reja të monitorimit, realizimin e hulumtimeve të përbashkëta dhe shkëmbimin e ekspertizës profesionale. Ky bashkëpunim do të kontribuonte në përmirësimin e cilësisë së analizave dhe në zhvillimin e praktikave inovative në monitorimin mjedisor.

Zhvillimi i një sistemi të integruar kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor - Në planin afatgjatë, rekomandohet zhvillimi i një sistemi të integruar kombëtar të monitorimit dhe raportimit mjedisor, i cili do të mundësonte grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave nga të gjitha institucionet përgjegjëse përmes një platforme të vetme elektronike. Një sistem i tillë do të rriste cilësinë e të dhënave, do të shmangte duplikimet, do të përmirësonte koordinimin ndërinstitutional dhe do të lehtësonte raportimin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë raportimin sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

6. REFERENCAT

- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). (2025). *Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2024*.
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). (2025). *Raporti për Gjendjen e Ajrit 2025*.
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). (2025). *Raporti mbi përdorimin e qeseve plastike në Republikën e Kosovës*.
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) & European Environment Agency (EEA). (2025). *Mjedi i Evropës 2025 – Profili i Kosovës (Europe's Environment 2025 – Kosovo Country Profile)*.
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Ligji Nr. 08/L-067 për Inspektimet.
- Rregullorja (QRK) Nr. 08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.
- Pyetësori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN). (2025). Material i papublikuar.
- Pyetësori i Drejtoratit për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). (2025). Material i papublikuar.
- Pyetësori i Departamentit për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). (2025). Material i papublikuar.

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.



www.ecmandryshe.org

